

Etje Për Jetë Të Bollshme (java 5 nga 5)

Përshëndetje! Sa bukur kjo pjesa, lufta shpirtërore, që sytë tanë nuk e shohin. Kush do ta ndikojë jetën tonë, djalli, e keqja, bota, apo Jezusi? Kur Jezusi mbretëron mbi ne, çlirohemi nga prangat. Ne gjejmë rrugën e kthimit te Perëndia.

Sot e mbyllim serinë tonë prej 5 javësh. Kemi folur për 5 Etje që ka çdo njeri dhe që vijnë nga Perëndia dhe janë për të na afruar tek Ai. Nuk janë etje që i kemi vetëm para se të njohim Perëndinë, jo, i kemi herë pas here, i përjetojmë këto etje edhe pasi e gjejmë rrugën e Kthimit te Perëndia.

Cilat ishin ato?

Etja e parë: Etje për më Shumë.

* Të gjithë kemi etje për më shumë dashuri, të duam dhe të na dojë dikush.

* Ne kemi etje për të ditur qëllimin e jetës, arsyen pse të zgjohemi në mëngjes dhe çfarë të na motivojë të ecim përpara.

* Kemi etje për të ditur kuptimin pse ndodhin gjërat në jetë, gjëra që nuk ua dimë pyetjen por që duam ta dimë.

Etja për më shumë vjen nga Perëndia dhe nëse shkojmë për ta shuar tek Ai, miqësia jonë me Të do të thellohet më shumë.

Nëse shkojmë në vende të tjera për t'i shuar këto etje, miqësia jonë me Perëndinë do të ftohet, do të largohemi prej Tij.

Etja e dytë: Etje për një fillim të ri.

Vjen kur e kupton dhe thua *‘U lodha duke u munduar t’i shuaj vetë etjet e mia, por këto përpjekje më kanë çuar larg Perëndisë. Dua të kthehem te Perëndia por nuk kam forcë. Kam ngecur te Rrethi i Keqardhjes, e kuptoj që ia kam futur kot, e kuptoj që ky ves po më kontrollon, e kuptoj që jam shkëputur nga Perëndia, erdha në vete, e kuptova që jam larg Perëndisë dhe dua t’ia filloj nga fillimi por nuk di si.’*

Kjo na sjell në **Etjen e tretë:** Etje për Ndhimë.

Ky është momenti kur merr kthesën dhe nisesh për t’u kthyer në shtëpi. Kur e kupton dhe e pranon që nuk mundesh t’i shuash vetë etjet e tua dhe e kupton që ndihma e ka emrin Jezus. Ai është i vetmi që mund të të ndihmojë të ndryshosh. Ai mund të të japë fuqinë për ta thyer ciklin e keqardhjes dhe për të ndryshuar.

Kjo na sjell në **Etjen e katërt:** Etje për t’u dashur.

Ti u ktheve te Perëndia dhe e kupton që nuk duhet të ndryshosh para se të shkosh tek Ai. Kur e kupton që Perëndia të do pa kushte ashtu siç je, ky është momenti kur ti kupton se kush është identiteti yt i vërtetë, që ti je fëmijë i Perëndisë.

Sot do të flasim për **Etjen e Pestë:** Etje për Jetë.

Për të filluar dhe patur një jetë të re.

(nëse keni patur person nga kisha që janë pagëzuar pas mesazhit të javës së kaluar: Për ta bërë më emocionale këtë pjesë dua që të festojmë dhe të gëzohemi për personat që u

pagëzuan; çuna dhe goca që e kanë gjetur rrugën e tyre te Perëndia. Me pagëzimin e tyre ata na tregojnë të gjithëve: "Ne kemi vendosur t'i besojmë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar!" Ne kemi vendosur të kthehemi në shtëpi te Ati ynë.')

Le të lexojmë pasazhin nga Luka 15 të cilin e kemi patur si bazë përgjatë gjithë serisë sonë.

A ndihesh ndonjëherë sikur jeta jote nuk ka shumë gjallëri? Është shumë e thatë. Sikur jeta nuk ka shumë jetë.

Këtë do të shohim sot:

Si mund ta shuajmë etjen e vazhdueshme për Jetë, për gjallëri?

Lutja në javën e 5-të bëhet: *“Perëndi, dua që të jetoj jetën e re dhe të gjallë që më jep ti, me gjithë kuptim e saj.”* Jezusi e premtoi që ne mund ta kemi këtë lloj jete te **Gjoni 10:10**

Unë kam ardhur që të keni jetë e ta keni më bollëk.

Çfarë kuptimi mund ketë kjo pjesa e fundit, Jetë me Bollëk? Për shumë njerëz kuptimi, *Jetë me Bollëk*, do të ishte: *“Dua të kem më shumë nga sa kam tani.*

Dua një punë më të mirë se kjo që kam, një rrogë më të mirë, pushime më të mira nga ato që kam bërë, një lidhje të mirë, një marrëdhënie më të mirë në familje.”

Duken të bukura këto apo jo?

Ne natyrshëm duam diçka më të mirë, diçka më shumë nga sa kemi. Ne natyrshëm e lidhim *Jetën Me Bollëk*, me diçka më shumë nga sa kemi për momentin. Por Jezusi nuk po thoshte këtë gjë kur e tha vargun: "Unë ju jap jetë me bollëk".

Në gjuhën orgjinale në të cilën u shkrua Dhjata e Re, kishte dy fjalë të ndryshme për fjalën jetë. Njëra ishte fjala **BIOS**, nga ku vjen dhe fjala Biologji. BIOS ka kuptimin, jeta natyrale. Në jetën Bios futet gjumi, ngrënia...

A e di se njeriu në jetën e tij ka fjetur 250 mijë orë gjumë, ka ngrënë 76 mijë vakte, ka shkuar 200 mijë herë në banjë.

Këto janë pjesë e jetës BIOS.

Por ishte dhe një fjalë tjetër që përkthehet po jetë në Bibël dhe është fjala **ZOE**. Zoe, e përfshin jetën BIOS por shkon pak më tutje. Bios është ajo pjesa që kërkon të ketë më shumë se ç'ka tani; ka të bëjë më shumë me sasinë. Kurse ZOE ka të bëjë me cilësinë e jetës, me cilësinë e të jetuarit që vjen në momentin kur ti njeh Perëndinë.

Jeta ZOE është jeta e përjetshme, është ajo jetë e jona që nuk mbaron kurrë. Kjo lloj jete fillon kur kthehesh te Perëndia dhe nuk mbaron kurrë. Por, gjithashtu jeta ZOE ka lidhje edhe me cilësinë e jetës që na jep Perëndia sot.

Kur Jezusi tha: "*Unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.*" A e gjen dot për cilën jetë e kishte fjalën Ai, për Bios apo Zoe?

Jezusi po fliste për një jetë cilësore me Perëndinë e cila të ndryshon të shkuarën, i jep kuptim të sotmes dhe siguron të ardhmen, jo thjesht një lloj jete që ti të kesh më shumë. Kur ti e gjen rrugën e kthimit te Perëndia, ti zbulon jetën ZOE.

Ne kemi qenë duke parë historinë e djalit të humbur gjatë gjithë serisë dhe kemi parë kontrastin e jetës Bios dhe jetës Zoe.

Luka 15:11-12 *Një njeri kishte dy bij. Më i riu i tyre i tha babait: "Atë, më jep pjesën e pasurisë që më takon". Dhe i ati ua ndau mes tyre pasurinë.*

Pasuri, pasurinë, është fjala Bios. E thënë ndryshe babi e ndau jetën e tij bios mes dy bijve. Unë jam gati t'ua jap bijve të mi gjithë jetën Bios që kam, por shpejt ata do të kuptonin se të kesh më shumë nuk do të thotë që do të kenë jetë të ngopura.

Jeta Zoe, është jeta me Atin, me Perëndinë. Perëndia nuk do që ta kemi mendjen vetëm te jeta Bios ndërkohë që Ai na ka krijuar për jetën Zoe. Perëndia do që të jetojmë jetën me bollëk, jetë **me** Të dhe jetë **në** Të.

Ne mund të kemi shumë ide të mira se si mund të shuhet etja për jetë, por së pari, le të shikojmë se çfarë na ofron Ati Perëndi, që të kemi një jetë Zoe gjithë kohës. Jeta ZOE ka këto elementë brenda saj, sepse Perëndia do që të kemi jetën Zoe, jetën e gjallë, të plotë dhe të lidhur me Të, kur jemi këtu në tokë.

Festojmë: Festojmë Për Ata Që Ishin Të Humbur dhe u Gjetën. Para se Jezusi të tregonte historinë e djalit plangprishës, Ai tregoi dy histori të tjera kur dikush ka humbur diçka me vlerë. Tek e para është historia e dikujt që ka 100 dele dhe i ka humbur 1 dele. Ai del e kërkon për delen e humbur derisa e gjen dhe kur e gjen: *“I thërret miqtë dhe fqinjët dhe u thotë: Gëzohuni bashkë me mua, sepse e gjeta delen time që më kishte humbur.”* **Luka 15:6**

Historia e dytë është për një grua që ka humbur një monedhë të çmuar. Ajo e kthen shtëpinë mbrapsht derisa e gjen dhe kur e gjen: *“fton tok shoqet dhe fqinjët, duke thënë: “Gëzohuni bashkë me mua, sepse e gjeta dhrahminë (monedhën) që kisha humbur”.* **Luka 15:9**

Pastaj është historia e tretë, historia që kemi folur ne, djali i humbur. Siç e kemi parë, kur djaloshi i afrohet shtëpisë, i ati i del përpara me vrap më shumë dashamirësi. Dhe pastaj thërret të gjithë sepse ka një lajm për të dhënë: *“të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri”.* Dhe filluan të bënin një festë të madhe. **Luka 15:23-24**

A e dallove se çfarë gjëje të përbashkët kanë tre historitë? Ndodhi kur u gjet delja e humbur, ndodhi e njëjta gjë kur u gjet monedha e humbur, ndodhi kur u gjet djali i humbur. Çfarë ishte? Lajmi përhapet kudo, sepse ajo që ishte e humbur tani është gjetur dhe është koha për të festuar.

Të gjithë vijnë për festë tek shtëpia e Atit.

Nëse ti e ke gjetur rrugën e kthimit te Perëndia, atëherë ke një arsye të madhe për të festuar. Ti ishe i humbur dhe tani u gjete. Të jepet mundësia për ta shumëzuar me zero të shkuarën, për ta pastuar. Të është dhënë një qëllim për të jetuar. Të është dhënë shpresë për të ardhmen.

Nëse do që të kesh jetën ZOE, ta përjetosh atë, festo kur dikush që ishte i humbur dhe është gjetur. Ne duhet të festojmë gjithmonë.

Sa herë që ne festojmë para Perëndisë, për gjërat që Ai ka bërë, kjo e forcon dhe e thellon pak me shumë miqësinë tonë me Të.

Psalmisti thotë: *“Zoti kënaqet me popullin e tij...”* **Psalmi 149:4.** Perëndia kënaqet kur ti kalon kohë me Të. Kur ti e fton atë për të kaluar kohë së bashku në mëngjes dhe e nis ditën me Të, apo feston me të tjerët, kjo i sjell shumë kënaqësi Perëndisë. Jo vetëm kaq, por është jetë dhënëse, i jep jetë, energji shpirtit tënd. Kur feston, ky është përjetimi i parë që na ndihmon të jetojmë jetën ZOE. Cila është e dyta?

Lidhemi: Zbulojmë që jemi më mirë bashkë.

Është bërë një studim, dy përvojat më të fuqishme që të ndihmojnë të kesh përjetime të mira në jetë janë kur arrin diçka që ke synuar dhe kur ke një shoqëri të mirë, kur ke gjetur një shok/shoqe të besueshme.

Dhe ajo që po ndodh më shumë është se njerëzit po

fokusohen shumë tek e para, por po lënë gjithnjë e më shumë pas dore të dytën. Nuk ka asgjë të keqe të arrish atë që synon, por mos hiq dorë nga lidhjet, nga shoqëria.

Njerëzit që arrijnë shumë gjëra në jetë por nuk kanë shoqëri, në fund të ditës janë njerëz të trishtuar.

Nga ana tjetër njerëzit që kanë shoqëri, edhe po nuk patën arritjet që duan prapë se prapë janë më të gëzuar dhe të lumtur sesa ata që kanë arritur gjëra por janë vetëm.

Ky kërkim nuk është ndonjë zbulim i madh shumë, sepse në fund të fundit kështu na ka krijuar Perëndia, që të jemi të lidhur me njëri-tjetrin.

Ti nuk mund ta përjetosh jetën ZOE i vetëm.

Kur lidhemi, kuptojmë se jemi më mirë bashkë sesa vetëm.

Kur lidhesh me njerëz të tjerë, njerëz që e kanë gjetur rrugën e tyre te Perëndia, ti e kupton që jeta është më e mirë dhe më e bukur kur është e rrethuar me njerëz të tillë.

Në jetën e re që na jepet nga Perëndia, na duhet inkurajim nga dikush dhe dikush që na mban përgjegjës, sepse në këtë lloj forme do të rritemi dhe do të forcohemi në udhëtimin me Perëndinë.

Kur je në një grup te madh si ky sot, nuk ke mundësi të lidhesh, flasësh, pyesësh. Edhe formati i festimit është i tillë ku ti rri dhe merr, shikon, dëgjon, përjeton, por nuk ke shumë hapësirë për të pyetur, për të ndarë, për t'u lutur.

Prandaj **GRUPET** e **VOGLA** janë shumë të mira për këtë punë, aty ti mund të bësh pyetje, njeh të tjerët, diskuton një

pjesë të Biblës, ndihmon dikë, dikush tjetër të ndihmon ty. Ati Perëndi do që të lidhemi dhe të ndajmë me njëri-tjetrin.

Kur ti qëllimisht lidhesh dhe je pjesë e një grupi të vogël, atëherë ke më shumë mundësi për të përjetuar jetën Zoe të cilën të jep Perëndia.

Kontribuoj: Bëhem pjesë e planit të Perëndisë.

Perëndia ka një plan, një ëndërr të madhe për këtë botë dhe do që ti të jesh pjesë e saj. Perëndia ka një plan për Shqipërinë dhe qytetin tonë. Ëndërra e Tij, synimi i Tij i madh është që çdo njeri të ketë mundësi të dijë, të dëgjojë, të kuptojë se Perëndia e do atë person. Perëndia do që çdo person ta gjejë rrugën e kthimit tek Ai. Ne besojmë që Perëndia do të na përdorë që të ndihmojmë shumë njerëz të gjejnë rrugën e kthimit te Perëndia.

Perëndia të fton ty që të kontribosh në këtë gjë. Ti ke rolin tënd në këtë ëndërr të madhe të Perëndisë. Dëshira e Tij është që të hedhësh hapin i pari për t'i treguar për Dashurinë e Perëndisë, sepse ishte Ai i pari që erdhi dhe të deshi ty pa kushte. Kështu që ti mund të bësh diçka në ëndërrën, në planin e madh që ka Perëndia për botën, për Shqipërinë...

Do të doja të dija, nëse Jezusi do ta vazhdonte historinë e djalit të humbur, çfarë lloj jete do të kishte bërë ky djalë? Ka shumë mundësi që ai djalosh do të ketë patur dhembshuri kur ka parë një njeri të uritur në rrugë. Apo kur të dëgjonte një histori dështimi, nuk do të shkonte dhe ta gjykonte atë person

por do ta inkurajonte. Do t'i ketë treguar gjithë fshatit, qytetit, për dashurinë e Atit.

Kur ne e kuptojmë me të vërtetë jetën e re, jetën Zoe, që na jep Perëndia, ne i shikojmë mundësitë që na sjell e ardhmja në formë komplet ndryshe. Ndryshojnë prioritetet. Jeta bëhet më e plotë, më e mirë, më e madhe se ç'ka qenë më parë.

Jeta jote me Jezusin është udhëtim që nuk ke pse e bën vetëm. Në fakt kur ti fillon këtë udhëtim nuk do të jesh asnjë çast pa Atin Perëndi.

Nëse e gjen veten larg, duke kërkuar si të shuash etjet e tua, ose duke menduar që ti i di të gjitha... ti e di se çfarë të bësh. Eja te jeta që është plotësisht e gjallë. Ti tani e mësove rrugën për në shtëpi, dhe mos harro që në shtëpi është vendi yt.

Sepse kur je në shtëpi, Krishti është me ty, jeton në ty dhe kjo sjell, kjo bën ndryshimin, jeta Zoe!

Le të lutemi!